

Programi vii: Shëndeti, sporti dhe edukimi fizik

Rëndësia e përgatitjes për një të ardhme pozitive lind nga mënyra së si bota akademike lidhet me kërkesat reale praktike të shoqërisë dhe individit. UniBa ofron Programet me një qasje konkrete për individët për secilin sektor nëpërmjet formimit teorik dhe atij praktik. Krijimi i një qasjeje novatore në fushën e shëndetësisë dhe sportit duke plotësuar kërkesat e edukimit ndaj aktivitetit fizik synon të sjellë një ofertë të integruar në të gjithë zinxhirin lidhës mes shëndetit, sportit dhe edukimit fizik. Arritja përfundimtare për një shoqëri sa më të shëndetshme dhe me mirëqenie të lartë, vjen me doemos nga ky rrugëtim i Universitetit Barleti falë shumë iniciativave të ndërmarra .

Hyrje

Lidhja e shëndetit me sportin si dhe ndikimi i këtyre dy faktorëve në mirëqënien e përgjithshme të individit janë të ditura dhe të konfirmuara si elementë themelorë të një shoqërie të shëndetshme.

Njohurinë kryesore të shëndetit si: faktorët anatomikë, funksionet kryesore të organeve të njeriut, rëndësia e përkujdesjes së trupit, ndihmojnë sportin dhe sportistët për të qënë në top formën e tyre dhe për të shprehur kështu vlerat dhe kapacitetet konkurruese. Edukimi fizik përbën një hallkë të rëndësishme në mësimin, aplikimin dhe vazhdueshmërinë e faktorëve përcaktues mbi shëndetin dhe mjeshhtërinë sportive.

Një ndër shtyllat e strategjisë në Universitetin Marin Barleti është pikërisht ndërthurja e këtyre sektorëve të ndryshëm në programe akademike si : Bachelor në “ Edukim Fizik dhe Sporte “ , Master Shkencor në “ Mësuesi, Edukim Fizik dhe Sporte “, Master profesional në “ Mësuesi Edukim Fizik dhe Sporte “, Operatorët e Shëndetit, Operator Fitness, si dhe programe afatshkurtëra certifikimi si Udhërrëfyes Turistik .

Synimi i këtyre programeve është plotësimi i kërkesave të shoqërisë në të gjitha nivelet e organizimit të saj në shkollë: rekreacion, rehabilitim, sport elitare, etj. Për specialistë të kualifikuar me dije bashkëkohore, të gatshëm që të përballojnë dhe plotësojnë nevojat gjithnjë e në rritje të shoqërisë shqiptare për aktivitet fizik e sport në të gjitha hallkat dhe shtresat e saj.

Njëkohësisht këto programe synojnë që të përgatisin specialistë që të jenë të gatshëm edhe në tregun ndërkombëtar të punës, si një aspekt shumë i rëndësishëm i të ardhmes së punësimit të brezave të rinj të vendit.

Praktikat profesionale në strukturat e duhura, kontakti me logjistikën, teoritë në auditorë janë të ndërthurura me njëra tjetrën për të patur në fokus edukimin fizik (të trupit) i cili arrihet me një aktiviteti fizik konstant për të patur shëndet të plotë fizik dhe mendor.

Rëndësia e programit



Rëndësia e përgatitjes për një të ardhme pozitive lind nga mënyra së si bota akademike lidhet me kërkesat reale praktike të shoqërisë dhe individit. Përgatitja e tyre teoriko-praktike ndiqet nga ekspertët e fushës në çdo hap duke ndërthurur nocionet teorike me ato praktike për të siguruar shëndetin si dhe edukimin ndaj tij. Sektorët e shëndetit, sportit dhe edukimit janë sektorë me rëndësi dhe impakt social në kohët e sotme. Programet dhe iniciativat më të rëndësishme ndërkombëtare mbështesin këta sektorë. Nevoja e tregut për profesionist të kualifikuar në këto sektorë si dhe nevoja në përgjithësi e shoqërisë për të pasuruar kohën e lirë me aktivitete të shëndetshme i jep rëndësi programit.

Cfarë ofron programi?

Programet ofron një qasje konkrete për individët për secilin sektor nëpërmjet formimit teorik dhe atij praktik. Krijimi i një qasjeje inovatore në fushën e shëndetësisë dhe sportit duke plotësuar kërkesat e edukimit ndaj aktivitetit fizik. Do të synojmë të sjellim një ofertë të integruar në të gjithë zinxhirin lidhës mes shëndetit sportit dhe edukimit fizik pasi arritja përfundimtare për një shoqëri sa më të shëndetshme dhe me mirëqenie të lartë vjen me doemos nga ky rrugëtim i ndërmarrë nga Universiteti Marin Barleti falë edhe iniciativave të sipërpërmendura.

Programi ofron formime akademike në nivel Bachelor, Master por dhe një sërë programesh të tjera profesionale të akredituara për të cilat pajiseni me certifikatë.

Mbështetje në strukturën e UniBa, Shoqata shumë-sportëshe Barleti, Qendra e trajnimit dhe Testimit Barleti si dhe bashkëpunimi me një sërë institucionesh dhe organizatash apo shoqatash sportive i jep soliditet programit. Programi ofron cilësi dhe standarte të larta bashkëkohore nëpërmjet një stafi profesional dhe të kualifikuar.

Shëndeti dhe mirëqenia:

Industria e Mirëqenies përfaqëson sot, 5.3% të prodhimit global dhe padyshim, pritet që ajo të zgjerohet më tej në vitet e ardhshme. Veprimtari si Yoga, Meditimi, Ushqimi, Aktiviteti Fizik, po zënë më shumë hapësira në stilin e jetesës moderne në të gjithë globin.

Veprimtaria e programitka në fokus zhvillimin e sektorit të shëndetit duke u ndalur në tre aspekte kryesore: **1.** Pasurimin e kohës së lirë për të gjithë me aktivitete të shëndetshme si yoga, meditim, zumba, aquagym, këshilla për stilin e të ushqyerit...etj, duke i ofruar këto shërbime për të gjithë. **2.** Formimin e profesionistëve për sektorin e shëndetit dhe mirëqenies nëpërmjet kurseve cilësore të trajnimit dhe certifikimit me standarte ndërkombëtare. **3.** Zhvillimin e aktiviteteve dhe iniciativave gjithëpërfshirëse për të promovuar stilin e shëndetshëm të jetesës dhe përfshirë qytetarët në këto aktivitete, për t'i ndërgjegjësuar për rëndësinë e këtij sektori. Do të ofrohen një sërë programesh kualifikimi si:

- Instruktor Yoga
- Instruktor Fitness
- Instruktor Zumba
- Instruktor AquaGym

- Këshillues shëndetësor

Sporti:

Sporti është pika e fortë veprimtarisë tonë, aktiviteti fizik përmirëson mirëqënien e përgjithshme dhe është në fokus të të gjithë iniciativave Europiane. Mbështetja në Fakultetin e Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit, të Universitetit Marin Barleti shërben si motor për zhvillimin dhe formimin e profesionistëve të së ardhmes në këto sektorë dhe afrimin e të rinjve me praktikën dhe ekperiencat ndërkombëtare nëpërmjet programeve Erasmus+, të Bashkimit Europian. Shoqata shumë-sportëshe Barleti është struktura bazë e të gjithë veprimtarisë praktike, shëmbull i suksesit të sportit me ekipin Barleti Volley por edhe me ekipe dhe sportistë të tjerë elitare, ekipet universitare dhe sporti për të gjithë. Bashkëpunimi me “KOKSH”, por edhe me federatat më të rëndësishme në vend, duke qënë gjithmonë pjesëmarrës aktiv kudo ku ka sport. Ofrohen programe studimi si:

- Bachelor Edukim Fizik dhe Sporte
- Master Profesional në “Mësuesi Edukim Fizik dhe Sporte “
- Master Shkencor në “Mësuesi Edukim Fizik dhe Sporte “

Programe profesionale:

- Operator në Fitnes dhe organizim eventesh
- Operator në Përkujdesje Shëndetësore

Trajnime dhe certifikime:

- Certifikim si trajner sporti në:
 - i. Futboll (bashkëpunim me FSHF)
 - ii. Basketboll (bashkëpunim me FSHB)
 - iii. Volejboll (bashkëpunim me FSHF)
 - iv. Taekondo (bashkëpunim me IFTC)
- Kurse trajnimi në: Menaxhim dhe Administrim Sporti
- Certifikim për Lifeguard (bashëpunim me LifeguardAlbania)



- Certifikim për Udhërrëfyes Turistik, Kulturor, Lokal dhe i Aventurës në disiplina të ndryshme sportive.

Këto programe përgatisin:

1. Mësues të edukimit fizik në sistemin parauniversitar
2. Pedagogë të sportit në shkollat e larta
3. Trajnerë të sporteve të ndryshme.

Edukimi:

Edukimi në veprimtarinë e programit shihet si pikënisje për zhvillimin e shoqërisë në përgjithësi dhe rritjen e standarteve në të gjitha fushat. Të investosh në edukim do thotë të investosh në arsimim, në aftësim profesional dhe përditësim të vazhdueshëm të njohurive, për ne do të thotë të investosh në të ardhmen. Mbështetja tek Universiteti Marin Barleti është një siguri për veprimtarinë tonë, stuktura moderne dhe suporti nga pedagogët dhe profesionistët më të mirë të Fakultetit të Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit me :

- Departamentin e Edukimit dhe Sporteve
- Departamentin e Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional
- Departamentin e Turizmit, Mikëpritjes dhe Rekreacionit
- Departamentin e Shkencave të Sjelljes dhe Shëndetit.

Sektori i edukimit do të synojë që të krijojë mundësi formimi, edukimi dhe informimi për risi në të gjithë fushat e veprimtarisë tonë.

Qëllimet e identifikuara të këtyre sektorëve janë:

- Të kthehet në fokus të stilit të jetesës së përditshme mirëqënia psiko – fizike.
- Të promovohet shëndeti, sporti dhe edukimi, si vlera dhe baza të funksionimit të shoqërisë
- Të rinjve dhe kryesisht studentëve t’u ofrohen variante të reja punësimi, në një treg ku dita ditës këto mundësi ngushtohen.
- Veprimtaria e programit të ketë në kohë impakt ekonomik dhe social në realitetin shqiptar dhe pse jo në atë mbarë rajonal.
- Ofrimi i shërbimeve cilësore nëpërmjet trajnimit dhe certifikimit, por edhe rikonceptimi dhe pasurimi i kohës së lirë në të tre sektorët: shëndetit, edukim dhe sportit.



- Bashkimi në iniciativat dhe projektet ndërkombëtare, në fushat e shëndetit, sportit dhe edukimit nëpërmjet aplikimit konstant dhe implementimit të tyre konkret në territorin tonë por edhe realizmi i projekteve të përbashkëta me vendet e rajonit.

Strukturat mbështetëse.

1. Universiteti Marin Barleti
2. Shoqata Barleti
3. Akademia Barleti
4. Qendra e testimit dhe trajnimit Barleti
5. Instituti Adriapol
6. Instituti Bird
7. Instituti Aipa

Bashkëpunëtorët dhe partnerët:

1. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
2. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
3. USAID
4. KOKSH
5. Federata Shqiptare e Sportit Universitar
6. Federata Shqiptare e Sportit Shkollor
7. Albanian Adventure
8. Federata Shqiptare e Shpëtimit të jetës